



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

Nr. 5743 Prot.,

Tiranë, më 4.11. 2023

**SHPALLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE  
NË  
DRAKU VLORË**

Në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në RSH”, i ndryshuar, neni 19, pika 1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në RSH”, ligjit nr.9863, datë 28.1.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar, ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, i ndryshuar, ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në VKM-në nr. 708, datë 9.9.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, Urdhrit të Kryeministrit nr. 128, datë 26.10.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, Rregullores së Brendshme për organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, të miratuar me Urdhrin nr. 297, datë 23.6.2022 të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Urdhrin Nr. 659 Prot., datë 2.2.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së për miratimin e Manualit të Rekrutimit,

1. **Autoriteti Kombëtar i Ushqimit** shpall **1 (një)** pozicion të lirë pune në **Drejtorinë Rajonale të AKU-së, Qarku Vlorë** si vijon:

- 1 (një) pozicion i lirë pune **“Specialist (Jurist)”** në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme.

**A) Kriteret e veçanta për vendet e shpallura vakante:**

Për pozicionin **“Specialist (Jurist)”** në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme, kategoria IV-3.

- **Arsimi:**

Të zotërojë diplomë të nivelit minimal “Bachelor” ose diplomë të nivelit “Master Profesional” ose diplome të nivelit “Master i Shkencave” ose “Master profesional të perfutur

në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike” ose të barazvlefshme me to, në fushat e kërkuara:

- Shkenca Juridike

*\*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.*

- **Përvoja:**

- Të ketë të paktën 1 vit eksperiencë pune;
- Të ketë njohuri shumë të mira të specialitetit brenda fushës profesionale, sipas veprimtarisë që mbulon;
- Të ketë njohuri të mira të procedurave administrative; aftësi për të përcaktuar objektivat, vendosur prioritete dhe respektuar afatet; aftësi për të shqyrtuar, verifikuar dhe vlerësuar;
- Të ketë njohuri të përdorimit të programeve bazë kompjuterike;
- Preferohet të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze/të huaja.

## **B) Kriteret e veçanta për vendet e shpallura vakante**

Personat e interesuar duhet të plotësojnë këto kriteret të përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të ketë integritet të lartë profesional e moral;
- Të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës;
- Të mos jetë përjashtuar/shkarkuar nga administrata publike;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe prezantimi.

## **C) Rregullat mbi mënyrën, afatit e dorëzimit të aplikimeve dhe kualifikimin e kandidatëve:**

1. Personat e interesuar duhet të dorëzojnë CV dhe dokumentacionin përkatës si vijon:
  - Kërkesë për punësim;
  - Jetëshkrim;
  - Fotokopje të diplomës të noterizuar me origjinalin;  
Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
  - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
  - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
  - Vetëdeklarim/vërtetim të gjendjes gjyqësore;
  - Vetëdeklarim të mos jetë përjashtuar/shkarkuar nga administrata publike.

*Shënim: Mosdorëzimi i dokumenteve të mësipërme dhe mosplotësimi i kriterëve, e s'kualifikojnë automatikisht aplikantin.*

2. Dorëzimi i dokumentacionit do të bëhet brenda 3 ditëve nga data e shpalljes në faqen zyrtare [www.aku.gov.al](http://www.aku.gov.al) në rrugë zyrtare nëpërmjet adresës email [bnjz.aku@aku.gov.al](mailto:bnjz.aku@aku.gov.al).
3. Aplikimet pranohen nga data 14.11.2023 deri në datë 17.11.2023 përfshirë të dyja këto data.
4. Brenda 1 dite pune struktura përgjegjëse për burimet njerëzore pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët, mban procesverbal evidentues mbi mangësitë ose jo në dokumentacion dhe kryen shpalljen në faqen zyrtare [www.aku.gov.al](http://www.aku.gov.al) të njoftimit për kandidatët e përzgjedhur.
5. Çdo kandidat ka të drejtën për ankim jo më vonë se 24 orë nga shpallja e njoftimit.
6. Njoftimi dhe komunikimi me kandidatët, do të bëhet nëpërmjet numrit të telefonit ose adresës së postës elektronike të deklaruar.
7. Struktura e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e procedurave të rekrutimit dhe hartimin dhe arkivimin e dokumentacionit përkatës.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**EDMOND RRUSHI**

